

VENDIM
Nr.943, datë 17.11.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LUMAS TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lumas të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lumas, të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.1494, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lumas të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lumas e qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Lumas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
289-305	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
306-310	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
311-330	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
331-360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
361	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
362	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
363-402	Varrezat publike	Në pronësi
403	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
495-537	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
538-558	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
559-1071	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi